



KOALICIONI PËR NXITJEN E PJESËMARRJES SË GRAVE DHE TË RINJVE NË POLITIKË

COALITION FOR PROMOTION OF WOMEN AND YOUTH IN POLITICS



FTESË

KONFERENCË PËR SHTYP

PREZANTIMI I MANIFESTIT RINOR “RINIA ZGJIDHJA, JO PROBLEMI”

7 Dhjetor 2012, Hotel Tirana International, salla Onufri, ora. 10.00

“Rini dëgjo dhe reago! Është radha jote të dalësh në skenë. Fillo që këtu të reflektosh, kërkosh dhe veprosh. Ne, të Rinjtë e Shqipërisë duam të vendosim të gjithë bashkë për të ardhmen tonë, dhe jo disa të vendosin për të gjithë...”

“Lidershipi i të Rinjve të Tiranës”, në bashkëpunim me CRCA dhe Koalicionin për Nxitjen e Pjesëmarrjes së Grave dhe të Rinjve në Politikë, ju fton të ndiqni nga afër kërkesat e të rinjve drejtuar qeveritarëve në Konferencën për Shtyp, organizuar në kuadër të Ditës Kombëtare të Rinisë. **Prezantimi zhvillohet më datë 7 Dhjetor 2012 (e Premte), ora 10.00, pranë Hotel Tirana International, salla Onufri.**

Ky Manifest do tu kërkojë Partive Politike, Parlamentarëve, Qeverisë dhe Kryetarëve të Bashkive e Komunave në Shqipëri, të adresojnë shqetësimet kryesore dhe pritshmëritë që të rinjtë kanë dhe që partitë politike, autoritetet e të zgjedhurit qendrorë dhe vendorë duhet ti kenë parasysh dhe të marrin masa për ti plotësuar ato.

Manifesti Rinor është një dokument që parashtron kërkesat kryesore të të rinjve shqiptarë, evidentuar nga problemet dhe shqetësimet e tyre. Ky Manifest është formuluar nga grupi rinor “Lidershipi i të Rinjve të Tiranës” dhe do të prezantohet nga vetë të rinjtë.

Ju mirëpresim,

Lidershipi i të Rinjve të Tiranës

PROGRAMI

09.45 – 10.00	Regjistrimi i pjesëmarrësve
10.00-10.10	Hapja e Konferencës Znj. Enida Bogdani, lehtësuese e grupit rinor "Lidershipi i të rinjve të Tiranës"
10.10 – 10.40	Prezantimi i Manifestit Rinor dhe kërkesave të tij "Lidershipi i të rinjve të Tiranës" Disufian Pera - Hapja, Lutjona Lula - Edukimi, Florian Gjini - Punesimi, Dafina Peçi-Perfaqesimi, Lorenci Gjurgjaj- Hapesirat publike, Eglantina Mataj -Shendetesia,
10.40 – 11.00	Pyetje & Përgjigje
11.00	Mbyllja e Konferencës